



Internet Rights & Principles Coalition

10 TË DREJTAT E INTERNETIT DHE PARIMET

Ky dokument përcakton dhjetë të drejtat dhe parimet kryesore që duhet të krijojnë bazën e qeverisjes së Internetit. Ato janë hartuar nga Koalicioni Dinamik Të Drejtat e Internetit dhe Parimet (IRP), një rrjet i hapur i individëve dhe organizatave të cilat punojnë për të mbështetur të drejtat e njeriut në mjedisin e Internetit. Parimet janë të rrënjosura në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe burojnë nga Kapitulli i cili nxirret në pah nga Koalicioni në lidhje me të Drejtat e Njeriut dhe Parimeve për Internetin.



Interneti ofron mundësi të pashembullta për realizimin e të drejtave të njeriut, dhe luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në jetët tona të përditshme. Prandaj, është genësore për të gjithë akterët, si publik ashtu edhe privat, të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në Internet. Po ashtu duhet të ndërmerren hapa për të siguruar se Interneti operon dhe evoluon në mënyra që përmbushin të drejtat e njeriut në masën më të madhe të mundshme. Për të ndihmuar në realizimin e këtij vizioni për një mjedis Interneti të bazuar në të drejta, 10 Të Drejtat dhe Parimet janë:

1) Gjithanshmëria dhe Barazia Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta, të cilat duhet të respektohen, mbrohen dhe përmbushen në një mjedis online.

2) Të Drejtat dhe Drejtësia Sociale Interneti është një hapësirë për promovim, mbrojtje dhe përmbushje të drejtave të njeriut dhe avancimin e drejtësisë sociale. Çdokush ka për detyrë të respektojë të drejtat e njeriut të të gjithëve në një mjedis online.

3) Mundësia e qasjes Çdokush ka të drejtë të barabartë për t'u qasur dhe shfrytëzuar një Internet të sigurt dhe të hapur.

4) Shprehja dhe Shoqërimi Çdokush ka të drejtë të kërkojë, pranojë dhe të jap informata lirshëm në Internet pa censurë apo ndërhyrje tjetër. Çdokush ka të drejtën të shoqërohet lirshëm me anë të Internetit, për qëllime sociale, politike, kulturore dhe qëllime tjera.

5) Privacia dhe Mbrojtja e të Dhënave Çdokush ka të drejtë në privacinë online. Kjo përfshin lirinë nga vëzhgimi, të drejtën për të përdorë enkriptimin, dhe të drejtën për anonimitet online. Po ashtu, çdokush ka të drejtë për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë kontrollin mbi të mbledhjen e të dhënave personale, ruajtjen, përpunimin, dhënien dhe hapjen.

6) Jeta, Liria dhe Siguria Të drejtat për jetë, liri dhe siguri duhet të respektohen, mbrohen dhe përmbushen online. Këto të drejta nuk duhet të nëpërkëmben, apo të përdoren për të nëpërkëmbur të drejtat tjera, në mjedisin online.

7) Diversiteti Diversiteti kulturor dhe gjuhësor në Internet duhet të promovohet, si dhe inovacioni teknik e politik duhet të inkurajohet për të lehtësuar morinë e shprehjes.

8) Barazia e Rrjetit Çdokush duhet të ketë qasje universale dhe të hapur në përmbajtjet e Internetit, pa prioritizim diskriminues, filtrim apo kontroll trafiku për qëllime komerciale, politike apo qëllime tjera.

9) Standardet dhe Rregullat Arkitektura e Internetit, sistemet e komunikimit dhe formatet e dokumenteve dhe të dhënave duhet të bazohen në standarde të hapura që sigurojnë ndërveprim të plotë, përfshirje dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

10) Qeverisja Të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale duhet të krijojnë bazat ligjore dhe normative mbi të cilat vepron Interneti dhe si qeveriset ai. Kjo duhet të ndodhë në mënyrë transparente dhe të shumanshme, bazuar në parimet e çiltërsisë, pjesëmarrjes përfshirëse dhe llogaridhënies.